VENDIM
Nr. 115/2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 36/2020 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE NIVELIT TË PAGAVE PËR AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, nenit 22, pika 5, të ligjit nr. 53/2019, "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Akademisë së Shkencave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 36/2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe nivelit të pagave për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ndryshon sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 2.11.2023.

Lidhja nr. 1. STRUKTURA, ORGANIKA DHE NIVELI I PAGAVE I AKADEMISË SË SHKENCAVE

DREJTIMI INSTITUCIONAL SHKENCOR

Pozicioni	Nr.	Kategoria
KRYESIA	**4**	
Kryetar	**1**	**C (0.700)**
Zëvendëskryetar	1	**D (0,650)**
Sekretar shkencor	1	**D (0,650)**
Sekretare e Kryesisë (Kryesekretare)	1	III-3
SEKSIONET SHKENCORE		
Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (anëtar Kryesie)	**1**	**E (0,600)**
Sekretar teknik i SSHSHA-së	1	IV-1
Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore-Teknike (anëtar Kryesie)	**1**	**E (0,600)**
Sekretar teknik i SSHTN-së	1	IV-1
QENDRA E PROJEKTEVE DHE KOORDINIMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR	**3**	
- Drejtor	**1**	**II-1**
- Koordinator kërkimor-shkencor	2	III-3

ADMINISTRATA

KANCELARI	**1**	**I-2**
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN	**3**	
- Përgjegjës sektori	**1**	**III-1**
- Specialist për burimet njerëzore dhe jurist	1	III-3
- Specialist për marrëdhëniet me jashtë	1	IV-1
SEKTORI I BOTIMEVE SHKENCORE	**6**	
- Përgjegjës sektori	**1**	**III-1**
- Redaktor shkencor (Specialist)	1	IV-1
- Redaktor shkencor (Specialist)	1	IV-1
- Bibliografe (Specialist)	1	IV-1
- Bibliotekare (Specialist)	1	IV-1
- Editor botimesh	1	Kl. IX
SEKTORI I BUXHETIT DHE FINANCËS	**4**	
- Përgjegjës sektori	**1**	**III-1**
- Specialist finance	1	IV-1
- Specialist për shpërndarjen e librit akademik	1	IV-2
- Magazinier/shofer (institucionit)	1	Kl. VIII
SEKTORI NDIHMËS		
- Shofer i kryetarit	1	Kl. V
- Punëtor mirëmbajtës	1	Kl. VI
- Punonjës pastrimi	1	Kl. II
- Arkivist-protokollist (Specialist)	1	IV-2
TOTALI		**29**

Shënime.

i. Koeficientët e kategoritë C, D dhe E për pagat e anëtarëve të Kryesisë janë në raport me pagën e Presidentit e sipas kategorive të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar me ligjin nr. 34/2023.

ii. Klasifikimi i pagave të nëpunësve të institucionit të Akademisë së Shkencave i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2023.

iii. Klasifikimi i pagave për punonjësit mbështetës/administrativë të institucionit të Akademisë së Shkencave i referohet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.5.2023.